

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, më 15.08.2022 lidhet kontrata e shitjes per shitjen e kuotave te shoqerise “**Gean Italia**” sh.p.k. e regjistruar ne QKB me NIPT **L81627020E** ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit “Per shoqerite tregtare” kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon :

SHITESIT:

Znj. Viola Terziu, e bija e Vasillaq, , e datelindjes 14.05.1981 , lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, e ve, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi me numer personal I15514044D (këtej e ne vazhdim referuar si “**Shitësit**”)

Andre Terziu, atesia Ervin, amesia Viola, i datelindjes 10.12.2013 , lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i identifikuar nga leternjoftimi me numer personal L31210063A duke qene i mitur perfaqesohet ne kete kontrate nga prindi Viola Terziu, nena e te miturti, ne cilesine e kujdestarit te vetem te femijes (referuar neneve 225,232 dhe 233 te Kodit te Familjes) (këtej e ne vazhdim referuar si “**Shitësit**”)

dhe

BLERESIT:

- 1- Z. Angelo Pindionello**, atesia Quintino, i datelindjes 05.07.1965 lindur ne Zvicer dhe me shtetesi italiane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr YA 5087755. (këtej e ne vazhdim referuar si “**Blerësi**”)
- 2- Z. Gerardo Cordella** , atesia Guido, i datelindjes 29.07.1963 lindur ne France dhe me shtetesi Italiane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr YB 1287860. (këtej e ne vazhdim referuar si “**Blerësi**”)

OBJEKT: Transferimin e kuotave te shoqerise “**Gean Italia**” shpk ne mbeshetje te ligjit “Per shoqerite tregtare” neneve te Statutit te shoqerise tregtare “Gean Italia” sh.p.k. ne masen 4 % qe i perkasin ortakeve Viola Terziu dhe Andre Terziu ne dobi te bleresve Z. Angelo Pindionello dhe Z. Gerardo Cordella.

Shoqerise “**Gean Italia**” shpk eshte regjistruar ne QKB dhe ne Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane si person juridik me nr NIPT-i : L81627020E. Kjo shoqeri e ushtron aktivitetin e saj ne ” Tirane, Rruga Fusha e Aviacionit, kulla 4, Ap.4.”

Me vendim te Asamblese se Ortakeve te dates 15.08.2022 ortaket Viola Terziu dhe Andre Terziu kane vendosur shitjen e pjese se kapitalit te zoteruar prej tyre, te kapitalit themeltar te shoqerise “Gean Italia” shpk ne masen 2 % ne vlere 2.000 leke dhe 2 % ne vlere 2.000 leke ne dobi te bleresve per:

- Z. Angelo Pindionello 2% (dy perqind) kundrejt shumes 2.000 leke (dy mije leke) dhe;
- Z. Gerardo Cordella 2% (dy perqind) kundrejt shumes 2.000 leke (dy mije leke).

Se bashku me kuotat e kapitalit bleresi blen dhe te gjithë te drejtat dhe detyrimet qe kjo shoqeri mbart deri ne kete moment te lidhjes se kesaj kontrate.


Perfundimisht kapitali i shoqerise “*Gean Italia*” shpk do te jete prone e Z. Angelo Pindionello ne masen 50% dhe vlere 50.000 leke dhe Z. Gerardo Cordella ne masen 50% dhe vlere 50.000 leke. Administrator i shoqerise do te mbetet Z. Gerardo Cordella.

Me depozitimim e akteve prane QKB-se bleresi ka detyrimin te paraqese ekstraktin e shoqerise me ndryshimet perkatese ne te gjithë institucionet dhe organet administrative ku kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin e saj dhe mbart te drejta dhe detyrime.

Kontrata u perpilua ne pese kopje me fuqi te barabarte secila.


SHITESI

Znj. Viola Terziu




Andre Terziu

(perfaqesuar nga prindi,
njekohesisht kujdestar i vetem i femijes)



BLERESIT

Z. Angelo Pindionello



Z. Gerardo Cordella

